



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

**KUVENDI KOMUNAL PEJË**

**Komiteti për Politikë e Financa**

**I.Numër: 060/01-76009**

**Pejë, datë: 19 Korrik 2022**



**PROCESVERBAL**

Nga takimi i VII-të i Komitetit për Politikë e Financa i KK-së Pejë, mbajtur me 19 korrik 2022, në ora 13:00.

Takimi u mbajt në sallën e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pos anëtarëve të komitetit, në këtë takim prezantojnë: Kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj,

Takimin e hapi dhe e kryesoi, kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj, i cili konstatoj se jemi të gjithë anëtarët prezent, dhe potencio se e kemi një pike shtes pika e nëntë për rend të ditës është dorëheqja e Xhevahire Ceku-Kelmendi nga komisioni komunal aksionar.

Unanimisht nga të gjithë prezent u miratua ky:

**RENDI I DITËS**

1. Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të komitetit dhe mungesa.
2. Shqyrtimi i Procesverbalit nga takimi i Komitetit për Politikë e Financa: dt. 20.06.2022.
3. Themelimi i Grupit punues për hartimin e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2023.

4. Raportimi i punës së Kryetarit të Komunës për gjashtë mujorin e parë 2022.
5. Informat për përfundimin e vitit shkollor, testit të arritshmerisë dhe testit të matures.
6. Raporti i Auditorit të Përgjithshëm dhe Plani i veprimit për të gjeturat e auditimit të vitit 2021.
7. Ridestinimi i mjeteve të rezervës buxhetore.
8. Raporti i të hyrave dhe shpenzimeve për gjashtëmujorin e parë, janar - qershor 2022.
9. Zavendësimi i anëtarit të Komisioni Komunal i Aksionerve të NPL “Ambienti” Sh.A.
10. Pytjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë rënditje siç janë pranuar:

*Për tu dorëzuar tek Sekretari jo më vonë se të Hënën, më dt.18 Korrik 2022.*

#### **I.**

**Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të komitetit dhe mungesa.**

Nuk pati.

#### **II. Shqyrtimi i Procesverbalit nga takimi i Komitetit për Politikë dhe Financa: dt. 20 qershor 2022.**

**Z. Labinot Panxha:** të proceverbali kam vërejtje sepse fjalimet nuk po konceptohen mirë, ose të shkruhen me kuptim ose të shkruhen fjalë për fjalë qysh po flasim.

Unanimisht nga të gjithë anëtarët prezent me vërejtjet që u dhanë, u miratua procesverbali i takimit të Komitetit për Politikë dhe Financa i datës: 20 qershor 2022.

#### **III**

**Themelimi i Grupit punues për hartimin e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2023.**

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: është komisioni me u themelu nga kuvendi ku si komision e ka për detyrë që të hartoj planin e punës së kuvendit për vitin 2023 komisioni përbehet prej 7 anëtarve ku 6 janë nga kuvendi dhe një nga shoqëria civile. Në fund të vitit miratohet ky plan i punës anëtarët caktohen në kuvend.

Unanimisht nga të gjithë anëtarët prezent i rekomandohet kuvendit për shqyrtim dhe miratim, Themelimi i Grupit punues për hartimin e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2023.

#### IV

#### **Raportimi i punës së Kryetarit të Komunës për gjashtë mujorin e parë 2022.**

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: kjo pikë është raport informativ për punën e ekzekutivit për me shumë kryetari do të flas në seanc.

Znj. Hidajete Nikqi : kisha kërku që të ken kujdes të pjesa e shkrimit meqense se janë dokumente zyrtare duhet te jetë raport i shkruar mirë dhe i kuptueshem të kenë me shumë kujdes në këto raporte.

Z. Labinot Panxha: unë në këtë material nuk e kam pa një raport të përmbledhur rreth punës së kryetarit, ku ceken arritshmerit dhe punët e tij po thjesht ma shumë një raport i drejtorive ku u drejtohen udhëheqve të tyre. Një prej tyre është të E- Pasuria , zyra për mjete themelore është e pa kuptueshme sepse aty është e cekne të shpenzimet komunale të E-pasuria ndoshta ma mire kish qenë të ishte e cekne nëpër secilen drejtori të pjesa e shpenzimeve komunale.

Z. Jeton Abazaj: ndoshta kjo ka të bëjë me një souftver që te futen komplet shpenzimet komunale diqka me një trajnim që e kanë pas sepse kjo është e cekne po me duket të administrata. Nuk ka pas nevoj të paraqitet këtu sepse paraqiten në raportin 6 mujor po këta kanë dasht me nda.

Z. Berat Ganiqi : meqense se kryetari nuk është ather mundet me u pergjigj drejtori për 6 mujorin e parë janë shpenzu 8643, 21euro për valën ndërsa për telefoni fikse janë shpenzu 3501,63 euro kish qenë mirë me ditë ka janë shpenzu gjithë këto mjete.

Z. Jeton Abazaj: sa i përket valës janë numrat e të gjithë zyrtarve që marin një mbushje prej 3 euro në muaj, me të tregu të drejt janë shkurtu shumë muajt e fundit qe 5 muaj jam dukë kerkuar prej kolegve që te verifikohen kush nuk është duke i përdor të terhiqen këta numra dhe me në fund jon marr masa konkrete e jon heke prej listë keta numra. Të telefonia fikse zyrtar që kanë centriks janë te lidhur me rrjetin qeveritar kanë nje shumë prej 10 euro në muaj dhe këta telefona janë të instaluar në disa drejtori këto janë shpenzimet që behën por në krahasim me vitin e kaluar kemi rënje të shpenzimeve.

Unanimisht nga të gjithë anëtarët prezent i rekomandohet kuvendit për shqyrtim, Raportimi i punës se Kryetarit te Komunës për gjashte mujorin e parë 2022.

## V

### **Informat për përfundimin e vitit shkollor, testit të arritshmerisë dhe testit të matures.**

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: është raport informativ lidhur me testin e arritshmëris ku drejtori në seanc do të jepe sqarim shtes.

Z. Berat Ganiqi: kishte qenë mirë qe të ishte drejtori sot këtu sepse cfar vlëre kemi ne ather si KPF. Pastaj kemi raste shumë siç ishte ai rasti në Novosell me na tregu si ndodhi cilat janë masat qe janë ndermarr.

Unanimisht nga të gjithë anëtarët prezent i rekomandohet kuvendit për shqyrtim, Informat për përfundimin e vitit shkollor, testit të arritshmerisë dhe testit të matures.

## VI

### **Raporti i Auditorit të Përgjithshëm dhe Plani i veprimit për të gjeturat e auditimit të vitit 2021.**

Kryesuesi Rexhep Kurtbogaj: është raport i gjetjeve të auditorit për vitin 2021 ku për me shumë do të flas drejtori .

Z. Jeton Abazaj: nëse e shohim a është raporti ma i mire ather fatkeqsisht nuk është sepse prej 38 komunave vetem 4 nuk u është klasifiku raporti, zyra e auditorit të pergjithshem nuk ka pasur mëshir për asnjë veprim që është kryer në komuna dhe shpeshher ka mat me standarde të dyfishta por prap nuk muj me tene që kanë qene tendencioz por kanë vepruar ndryshe për temat e njejta në raport me vitin e kaluar. Raporti është i kualifikuar dhe normal që ka tema që janë ngrit qe nuk janë të mira pra nuk është raport i mirë me u bo i sinqert por për ceshtjet tjera e kisha lën që në detaje me diskutu në kuvend ku janë përcaktu edhe veprimet konkrete ne kuader të planit, ka edhe gjetje të mira sepse në kuader të investimeve kapitale 10 milion nuk ka një të gjetur. Të subvencionet ka pas konflikt të interesit te bujqësia dhe kam kërku që te kthehen ato mjete ku ka pas keqpërdorime së nuk bjen mirë edhe para donatorit.

Unanimisht nga të gjithë anëtarët prezent i rekomandohet kuvendit për shqyrtim dhe miratim, Raporti i Auditorit të Përgjithshëm dhe Plani i veprimit për të gjeturat e auditimit të vitit 2021.

## VII

### **Ridestnimi i mjeteve të rezerves buxhetore.**

Z. Jeton Abazaj: është një material vetem një faqe ka të bëjë më një ridestnim të rezerves buxhetore është një gabim por që e permisoj e ju dërgoj duhet të ceket fondi burimor 96 mij janë grant qeveritar dhe 3700 janë të hyra vetanake. Nuk është fjala për rregullim lumenjeve por tani ju hspjegoj cfar është rezerva, që tri vite udhezimi administrativ 04-2019 që i klasifikon projekte

kapitale ku shpesh here ka ndodh që me i qit mjetet në rezerv buxhetore kur ka probleme. Në keto 100 mijë euro si rezerv kemi të drejt me i ridestinu në një projekt te ri për blerjen e disa kamerave qe kanë për qëllim rritjen e siguris në qytet.

Z. Berat Ganiqi: kur e pash Smart City mendova që ka të bëjë me ndonje platform ku qytetarët mundën me i paraqit kërkesat e kur e shpjegove kamera nuk po përkon me termin smart.

Z. Jeton Abazaj: janë kamera me të sofistikuar që i identifikojn edhe tabalet e automjeteve nuk është qellimi këtu me ndal vetem hajnin por me rrit në përgjithesi sigurin.

Unanimisht nga të gjithë anëtarët prezent i rekomandohet kuvendit për shqyrtim dhe miratim, Ridestinimi i mjetëve të rezerves buxhetore.

## VIII

### **Raporti i të hyrave dhe shpenzimeve për gjashtëmujorin e parë, janar - qershor 2022.**

Z. Jeton Abazaj : raporti e kam përfundu sot por jam duke i bërë edhe disa kontrollime dhe ju dërgoj sot pastaj e diskutojmë në seanc në detaje rreth rrjedhjes se të hyrave.

Me 7 vota pro 2 abstenime rekomandohet kuvendit për shqyrtim, Raporti i të hyrave dhe shpenzimeve për gjashtëmujorin e parë, janar - qershor 2022.

## IX

### **Zavendësimi i anëtarit të Komisioni Komunal i Aksionerve të NPL “Ambienti” Sh.A.**

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: kjo pikë ka të bëjë me zevendesimin e anëtares se kuvendit më kërkes personale të saj.

Z. Labinot Panxha: meqense kolegën e kemi këtu deshta me të pyet cila është arsyea?

Znj. Xhevahire Ceku- Kelmendi: është e shkruame aty qartë personale.

Unanimisht nga të gjithë anëtarët prezent I rekomandohet kuvendit , Zavendësimi i anëtarit të Komisioni Komunal i Aksionerve të NPL “Ambienti” Sh.A

**X . Pyetjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë rënditje siç janë pranuar:**

Z. Labinot Panxha: unë deshta me ngrit një pyetje lidhur më ndryshimin e orarit të mbajtjes së takimeve të Kpf-ës se ne e kemi miratur një planë të punës ku është percaktu edhe orari i mbajtjes në ora 10 e kështu pse ky ndryshim.

Z. Avni Gashi: për shkak se disa anëtar janë mesimdhënes është ndryshu orari për mos me i humb orët e mesimit.

Z. Labinot Panxha: askush nuk mundet me na përcaktu orarin e mbajtjes së takimeve, nuk mundemi me ju përshtat askuj, është ditë e lirë atë ditë edhe me ligj kur kemi takime. Se po ndegjoj jashtë fjal a jau ndryshoj orarin filan drejtori a kjo so mirë.


Z. Hidajete Nikqi: është mirë me mendu për femij se ato orë nuk munden me zevendesu është problem andaj për këtë arsye o mire me mbet prej orës 13.00, pastaj shikojm me rregullu orarin.

*Pjesë e këtij procesverballi është edhe audio incizimi i këtij takimi të Komitetit për Politikë dhe Financa.*

**Meqë u shqyrtuan të gjitha pikat e rendit të ditës e propozime të tjera nuk pati, kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj e shpalli të mbyllur këtë takim të KPF-së në orën 14:00 h.**

**Procesmbajtësi,**

**z. Avni Gashi**



**KRYESUESI,**  
**z. Rexhep Kurtbogaj**



